

Ekipet e mjekësisë familjare po ofrojnë shërbimet kryesisht në distancë në përputhje me udhëzimet më të fundit të autoriteteve shëndetësore me synim parandalimin dhe kontrollin e infeksionit nga COVID-19.

Mjekët e familjes vijojnë ndjekjen përgjithësisht me telefon të gjendjes shëndetësore të rasteve të dyshuara/konfirmuara me COVID-19 si dhe kryejnë triazh pasiv në përgjigje të telefonatave të mbërritura në QSH bazuar në skedën 'Triazh COVID-19' të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

## KUJDESI PËR PACIENTËT KRONIKË



- Mjekët e familjes po zbatojnë konsultimet në distancë përmes telefonit dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit për ndjekjen e gjendjes shëndetësore të pacientëve kronikë. Në këtë situatë ka dalë si nevojë prodhimi dhe vënia në dispozicion të ekipeve të Mjekësisë së Familjes të udhëzuesve klinikë të përshtatur për konsultat në distancë për një cilësi më të mirë të këtyre konsultave.
- Në mjediset e qendrës shëndetësore po zbatohen rregullat e distancimit shoqëror ("qëndrimin larg nga njëri tjetri më shumë se 1 metër").
- Vijon pajisja me medikamente në banesë për pacientët kronikë mbi 65 vjeç në përputhje me udhëzimet e Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (ju ftojme të shihni një video me foto nga puna në komunitet e qendrave shëndetësore në qarkun Dibër: <https://youtu.be/GYjcdxbgALs>)

## REAGIMI I HAP NË NDIHMË TË EKIPEVE TË KSHP-SË:

- Projekti Shëndet për të Gjithë është duke punuar për ofrimin e trajnimit online për ekipet e kujdesit shëndetësor parësor dhe Njësive Lokale të Kujdesit Shëndetësor në qarkun Dibër dhe Fier me qëllim parandalimin dhe kontrollin e infeksionit nga COVID-19. Trajnimi synon aftësimin e profesionistëve të KSHP-së lidhur me:

- rëndësinë, përzgjedhjen dhe përdorimin e duhur të pajisjeve të mbrojtjes personale
- masat e parandalimit të COVID-19 (higjena e duarve, ruajtja e distancës)
- njohjen dhe dallimin e simptomave të infeksionit të mundshëm me COVID-19
- përkufizimin e rastit, triazhimin dhe referimin sipas rregullave të përcaktuara nga autoritetet shëndetësore
- izolimin e shpejtë të rasteve të dyshuara

- HAP ka krijuar një hapësirë të dedikuar COVID-19 në faqen e vet zyrtare me informacione për 'Profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor' si dhe informacione për 'Publikun'. Faqja përmban materiale në shqip të përshtatura nga autoritete shëndetësore të huaja dhe kombëtare. Për më shumë, vizitoni <http://covid19.hap.org.al/>.

## MATERIALE REFERUESE PËR KUJDESIN PARËSOR



Instituti i Shëndetit Publik ka publikuar materiale edukuese/trajnuese me fokus profesionistët shëndetësore. Materialet janë shpërndarë përmes NjVKSH-ve. Këto materiale mund të gjenden gjithashtu në faqen zyrtare të HAP në hapësirën e dedikuar për COVID-19 së bashku me të gjitha vendimet e autoriteteve shëndetësore lidhur me menaxhimin e situatës COVID-19 nga KSHP me qëllim njohjen për zbatim nga ana e profesionistëve shëndetësorë dhe publikut.

Për më shumë informacion për situatën e COVID-19 në Shqipëri, vizitoni faqen zyrtare: [www.coronavirus.al](http://www.coronavirus.al)

Për tu informuar më shumë për Projektin Shëndet për të Gjithë, vizitoni [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



# Sfidat e kujdesit parësor në përballjen me COVID-19: Dëshmi nga profesionistët



Dr. Reldi Musta është mjek familje dhe drejtor i qendrës shëndetësore Kurjan\* e cila mbulon edhe fshatin Mbërs ku kanë qenë në karantinë 102 familje. Në këtë fshat ka pasur 2 raste të konfirmuara me COVID-19 çka solli edhe nevojën e karantinimit të të gjithë fshatit për të parandaluar përhapjen e mëtejshme. Si rezultat, periudha e karantinimit përfundoi në datë 1 prill pa raste të reja me COVID-19.

*'Kemi kontrolluar gjendjen shëndetësore të personave kryesisht me telefon duke iu kërkuar dy herë në ditë të masin temperaturën dhe raportojnë për probleme të mundshme shëndetësore.-thotë Dr. Reldi.- Gjithashtu, kemi ofruar shërbimin shëndetësor në banesë për pacientët që kanë pasur nevojë për mjekim.'*

Teksa flet për sfidat e hasura deri më tani, Dr. Reldi përmend nevojën e trajnimeve direkte të personelit të kujdesit shëndetësor parësor si pikë e parë kontakti me pacientët. *"Shpesh ndjehemi të pambrojtur mjaftueshëm ndaj kemi shumë nevojë të trajnohemi se si të mbrojmë më mirë veten tonë, kolegët dhe pacientët si dhe të pajisemi me më shumë mjete të mbrojtjes personale-thotë Dr. Reldi- Po bëjmë më të mirën që pacientët tanë ti trajtojmë lokalisht pa qenë nevojë ti dërgojmë në spital por kemi nevojë për më shumë mbështetje. Së fundi, iu lutemi qytetarëve të zbatojnë rregullat e bëra publike në media si dhe të komunikuara nga mjekët e familjes. Për çdo shqetësim, të komunikojnë në çdo kohë me mjekun tuaj të familjes."*

\*Qendra shëndetësore Kurjan (Bashkia Roskovec) i shërben 4766 banorëve. Ekipi i qendrës shëndetësore (përfshirë 2 ambulancat) përbëhet nga 1 mjek familje dhe 7 infermierë. QSH Kurjan u rikonstruktua nga Projekti Shëndet për të Gjithë në vitin 2018.

Duke qenë se në komunitetin ku ne shërbejmë kemi pasur raste me COVID-19, kam parë si nevojë konkrete trajnimet shtesë në përballjen me pacientë të dyshuar me COVID-19 duke qenë se ky është një virus i ri dhe nuk jemi përballur më parë. Na duhen trajnime konkrete lidhur me masat që duhen marrë në përballjen me këta pacientë, trajnime lidhur me veshjet specifike që përdoren në këto raste, mënyrën e veshjes dhe zhveshjes së tyre sepse duan një kujdes maksimal për të mos u kontaminuar prej tyre.

-Anisa Shpata, Infermiere, QSH Patos

Shëndet për të Gjithë është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i cili po zbatohet nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



Swiss TPH

Swiss Tropical and Public Health Institute

